

Buletini i Financave Publike - Nëntor 2014



nga Instituti për Politikë Publike dhe Mirëqeverisjen

Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë publikoi në datë 22 Dhjetor 2014 Statistikat fiskale për muajin Nëntor 2014. Në shërbim të analizës janë të disponueshme të dhënat kumulative për të ardhurat publike, shpenzimet qeveritare dhe investimet nga Janari 1998 deri në Nëntor 2014.

Duke analizuar ecurinë e financave publike, *Arben Malaj*, Kryetar Bordi i IPPM shprehet:

“Realizimi i të ardhurave konsolidon një trend përmirësues në raport me vitin e kaluar dhe afërsisht i barabartë me indeksin 10 vjeçar. Realizimi i shpenzimeve totale të buxhetit për muajin Nëntor dhe 11 mujorin është rritur, por mbeten akoma nën nivelin mesatar të dhjetë viteve të fundit. Niveli i realizimit të Investimeve publike me financim të brendshëm dhe të jashtëm është nën treguesit mesatarë të dhjetë viteve të fundit dhe vazhdon të mbetet pjesa kritike e buxhetit 2014”.

Krahasimet kryesore:

- **Të ardhurat publike** në muajin Nëntor 2014 shënuan vlerën 29.48 miliardë lekë. Krahasuar me Nëntorin 2013 vihet re një rritje prej 15.02 % e të ardhurave totale shkaktuar kryesisht nga rritja e të ardhurave nga tatimet dhe doganat.
- **Shpenzimet totale** për këtë muaj arritën vlerën e 37.88 miliardë lekë duke shënuar një rritje me 20.40 % krahasuar me shpenzimet totale të muajit Nëntor 2013.
- **Investimet publike** gjatë muajit Nëntor ishin në vlerën 6.89 miliardë lekë ose rreth 172.59 % më shumë në raport me investimet e realizuara në Nëntor 2013, nga një rritje në realizimet e investimeve me financim të brendshëm me 554.47%.

secretary@ippm.al
www.ippm.al

Rr. Ismail Qemali, P.27/1
Tirane, Shqiperi

*për t'u bërë pjesë e listës
prioritare ju lutem na
shkruani në
secretary@ippm.al*

Kryetar i Bordit:
Arben Malaj

Drejtoreshë ekzekutive
Ada Shameti

Instituti për politikë publike dhe mirëqeverisje

Regjistruar në Gjykatën e Tiranës
Nr regjistrimi 389
Rruga Ismail Qemali P.27/1
Tirane
Shqiperi
www.ippm.al

Analizë e mëtejshme e treguesve

Mbi bazën e të dhënave zyrtare të statistikave fiskale të publikuara nga Ministria e Financave është përgatitur një analizë më e fokusuar e treguesve kryesorë të financave publike.



Të ardhurat në buxhetin e shtetit

Totali i të ardhurave për muajin Nëntor në vlerë nominale ishte 29.84 miliardë lekë, ose 3.90 miliardë më shumë se në Nëntor 2013. Rritja prej 15.02% e të ardhurave në terma vjetore ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së të ardhurave tatimore me 12.15 %. Në Nëntor 2014 janë arkëtuar 2.96 miliardë lekë të ardhura tatimore më shumë se në Nëntor 2013, nga të cilat 1.86 miliardë ka qënë rritja e të ardhurave nga tatimet dhe doganat. Në këtë rritje ka ndikuar rritja me 7.50 % e të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar, dhe rritja me 59.90% e të ardhurave nga tatimi mbi fitim, këto të fundit nominalisht me 620 milionë lekë krahasuar me Nëntorin 2013.

Të dhënat kumulative tregojnë se gjatë 11-mujorit 2014 janë arkëtuar 36.99 miliardë lekë ose 12.66% më shumë se gjatë të njëjtës periudhë në 2013-n.

Sipas Indeksit të IPPM, në muajin Nëntor, të ardhurat e realizuara ndaj të ardhurave totale nga Buxheti 2014 janë 8.18 pikë përqindje më lart se pesha mesatare e të ardhurave të realizuara për muajin Nëntor gjatë 10 viteve të fundit, ndërsa si 11 mujor janë 0.44 p.p. më poshtë se indeksi.

Shpenzimet e qeverisë qendrore

Gjatë muajit Nëntor 2014, shpenzimet totale pësuan një rritje prej 20.40% krahasuar me Nëntorin 2013, duke arritur vlerën 37.88 miliardë lekë.

Shpenzimet për interesat në Nëntor 2014 u ulën me 6.83 % krahasuar ne Nëntorin 2013, ku vlen për t'u theksuar një ulje e shpenzimeve për interesat e brendshme me 15.30 % ose 395 milionë lekë në terma vjetorë.

secretary@ippm.al
www.ippm.al

Rr. Ismail Qemali, P.27/1
Tirane, Shqiperi

Instituti për politikë publike dhe mireqeverisje

Regjistruar ne Gjykatën e Tiranës
Nr regjistrimi 389
Rruga Ismail Qemali P.27/1
Tirane
Shqiperi
www.ippm.al

Gjatë 11-mujorit 2014, shpenzimet totale janë në nivelet e 370.45 miliardë lekë, 5.05 miliardë ose 17.79 % më shumë se gjatë periudhës Janar-Nëntor 2013.

Referuar Indeksit 10-vjeçar të IPPM 2004-2013, vlen për t'u theksuar se pesha e shpenzimeve totale të realizuara gjatë Nëntorit 2014 ndaj Buxhetit 2014, është 8.30 pikë përqindje mbi mesataren 10 vjeçare të shpenzimeve për Nëntorin, dhe 0.65 p.p. nën vlerën e Indeksit kumulativ për periudhën Janar-Nëntor 2013.

Investimet publike

Investimet publike në muajin Nëntor 2014 arritën vlerën nominale 6.89 miliardë lekë duke shënuar një rritje prej 4.36 miliardë lekë krahasuar me muajin Nëntor 2013, kjo e shprehur në terma relativë, 172.59% më shumë.

Referuar statistikave kumulative për Janar-Nëntorin 2014, investimet publike gjatë vitit 2014 janë 23.79 % ose 13.58 miliardë lekë më pak se investimet publike të kryera gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2013.

Sipas Indeksit të IPPM, pesha e investimeve publike të realizuara gjatë muajit Nëntor 2014 ndaj investimeve publike në Buxhetin 2014, është 10.25 pikë përqindje mbi mesataren 10 vjeçare për muajin Nëntor dhe 0.20 p.p. nën vlerën e Indeksit për 11-mujorin 2014.

Për të marrë në kohë reale Buletinin e Financave Publike ju lutem kontaktoni me Ada Shamenti, Drejtore Ekzekutive e Institutit për Politika Publike dhe Mirëqeverisje në adashamenti@ippm.al ose na shkruani në secretary@ippm.al

Informacione të mëtejshme mbi analizën e paraqitur në Buletinin e Financave Publike mund të gjenden në:

Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje

www.ippm.al/buletiniifinancavepublike

Ministria e Financave, Statistika mujore fiskale

www.minfin.gov.al



secretary@ippm.al
www.ippm.al

Rr. Ismail Qemali, P.27/1
Tirane, Shqipëri

Instituti për politika publike dhe mireqeverisje

Regjistruar ne Gjykatën e Tiranës
Nr regjistrimi 389
Rruga Ismail Qemali P.27/1
Tirane
Shqipëri
www.ippm.al